

AKTI I THEMELIMIT

dhe

STATUTI

I SHOQËRISEË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" ALPHACONS " sh.p.k

Sot, më datë 26 / 02 / 2024, në Tiranë,

Z. FESTIM BREGASI, shtetas shqiptar, lindur më **09-10-1983**, në **Çorovodë, Skrapar** madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pajisur me letërnjoftim nr. **034113354** dhe nr. Personal **I31009048M**, në cilësinë e ortakut të vetëm me 1 (një) pjesë të të kuotës të shoqërisë "**ALPHACONS**" **sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas parashikimeve ligjore të Republikës së Shqipërisë dhe

KAPITULLI I

EMRI, FORMA LIGJORE E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1

Themelimi

- 1.1. Emri i Shoqërisë është "**ALPHACONS**" **sh.p.k** (më tej referuar si 'Shoqëria')
- 1.2. Shoqëria është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin shqiptar.
- 1.3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 1.4. Aktiviteti i Shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të këtij akti.

Neni 2

Selia

Selia e ushtrimit të aktivitetit tregëtar të Shoqërisë është në adresën : Zona Kadastrale 8260, Rruga M.Gjollështa, Shkalla 1, Apartamenti 7, Tirane, Shqiperi.

- 2.1. Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe dispozitave të këtij Akt Themelimi dhe Statuti-

Neni 3

Objekti i Shoqërisë

3.1. Objekti i aktivitetit tregëtar të Shoqërisë do të jetë :

Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi. Punime dheu, tarracime, prodhim elementësh të parafabrikuara betoni e betonarme e kompletimi me instalimet e nevojshme, ndërtime civile, industriale, turistike, ndërtim rrugë, fusha aviacioni, veshje me asfaltobeton të rrugeve, ndërtim veprash arti, ndërtim ujesjellesash e kanalizime. Punime karpentjerie metalike, shpim pusesh gjeologjike inxhinierike e hidrogjeologjike etj. Rivelime dhe punime topogjeodezike etj. Veprimtari financiare të transferimit të parave në emer dhe për llogari të Subjektit Financiar-Jobanke. Veprimtari të Agjentit Komisioner. Në fushën e Projektimit të ndërtimit. Prova laboratorike në strukturën ndërtimore. Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri-porta e pontile. Konsulencë Juridike, import-eksport mineralesh. Auditim në financë dhe auditim në ndërtim. Hartim i raportit të vleresimit të ndikimit në mjedis, auditim mjedisor, hartim i ekspertizave për probleme mjedisore. Ekspert privat zjarrfikës. Master plane studime plane rajonale urbanistike, plan rregullus të pergjithshëm për qëndera të banuara dhe qytete. Për Shërbime Espertize dhe/ose Profesionale lidhur me Burimet Energjitike. Import, eksport, shitje-blerje dhënie me qira dhe nënqira automjetesh dhe ambjentesh. Vleresim i pasurive të paluajtshme. Projektme dhe Studime Urbanistike. Projektme e ndërtime civile, industrial turistike, bujqësore. Studime ambjentale, 2 projektme interieresh, projektim peisazhi e sistemimi. Studime e projektme hidrogjeologjike, projektme rruge, ura, porte turistike, të inxhinierisë elektrike, inxhinierisë hidromekanike, projektme konstruktive restaurime si dhe konsulenca për temat e mësipërme. Studime urbanistike të të gjitha niveleve; planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim strukturash beton arme, metalike, projektim autostrada heliporte dhe aeroporte. Projektim linjash dhe sistemesh të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë

elektrike, ujesjellës kanalizime, vepra ujitje, kullimi impiante vaditëse, diga dampa; projektim vepra naftësijellës, gazsjellës etj. Projektim fotogrametik, hartografik, topografik, konsulenca tekniko ekonomike sipas kategorive dhe nënkategorive të licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi që nuk përmëndët më sipër. Menaxhim dhe koordinim i projekteve të ndryshme, konsulenca të ndryshme në lidhje me shërbimet e mësipërme. Shërbime ndërhyrëse në raste emergjencash I.2.B. Çertifikim, menaxhim të efikasitetit të energjisë në ndërtesa, godina industriale dhe në transport. Impeksport, prodhim tregtim materiale ndërtimi, industriale e ushqimor, ashensore, mirmbajtje ashensore etj. Transportim mallrash e pasagjerësh, brenda dhe jashtë vendit. Grumbullim të bimëve medicinale. Ndërtimi, operimi i Hidrocentraleve deri në shitjen e energjisë së prodhuar. Grumbullimi dhe Transporti i Mbetjeve inerte. Trajtim/ magazinim ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane, ujrave e ndotura, llumin septik, mbetjet e ujërave të zeza. Ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore të lartësive të ndryshme rikonstruksione, ndërtim banesë me skelet mbi 8 kate. Ndërtime, mirëmbajtje rrugore, të kategorive të ndryshme, Ndërtim autostrade-pista-aeroporte-helioporte. Ndërtim hekurudhorë, punime speciale të shinave dhe traversave, punime në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit. Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10m dhe mbi 10m. Ekstrakada-ura metalike të varura, ndërtim tunele rrugore-hekurudhorë, ndërtime detare, ndërtime portuale-banki ena-basene-pontile, punime thellimi etj. Ndërtime hidraulike, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje të sistemit hidraulik-cimentime etj. Ndërtim impiante të sistemit të ujit, ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësijellës, ndërtim diga-damba deri në 10m, ndërtim galeritunele, ndërtim diga të larta. Vepra të vecanta punime speciale, sillose, kulla, kulla uji etj. B/arme metalike, forcime themeli e punime nëntokësore, izolime mbi dhe nëntokësorë nga ujrave, themele të veçanta, puse shpime 3 gjeologjike-inxhinjere, çpime për ujë. Punime restaurimi, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike. Punime shërbimi, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe-pyll, pastrimi i sipërfaqeve urbane, mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbanendriçimi e sinjalizimi urban.

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

3.1. Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR FILLESTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT

Neni 5

Kapitali themeltar dhe ortakët e Shoqërisë

- 5.1. Kapitali themeltar i regjistruar i Shoqërisë është i barabartë me ALL 500 000 (pesqind mijë Lekë). Ortaku i Shoqërisë deklaron se ka paguar kapitalin themeltar fillestar të Shoqërisë, sic është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në vlerë të plotë, ekuivalente me kuotat e plota që ai si ortak i vetëm zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 5.2. Ortaku do të konsiderohet përgjegjës kundrejt Shoqërisë dhe për këtë arsye do të përgjigje personalisht deri në vlerën e pashlyer të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 5.3. Kapitali themeltar do të zotërohet nga ortakët i vetëm :
 - I. **Z. FESTIM BREGASI**, do të zotërojë 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë me një vlerë të barabartë prej ALL 500 000 (pesqind mijë Lekë) ;
- 5.4. Ortaku deklaron se Kuotat e zotëruar nga Ai si më sipër janë paguar plotësisht .
- 5.5. Ortakët i vetëm i shoqërisë është **Z. FESTIM BREGASI**, i cili zotëron kuotat e plota të shoqërisë.
- 5.6. Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e paguar të kontributit në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE

Neni 6

Asambleja e Ortakëve

- 6.1. Asambleja e ortakëve përfaqëson organin më të lartë vendimarrës të Shoqërisë
- 6.2. Asambleja e Ortakëve ka funksionet e mëposhtme :
 - Përcakton politikën tregtare dhe ekonomike dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga Administratorët ;
 - Përcakton ndryshime në natyrën e biznesit (natyrën tregtare) të Shoqërisë ose fillimin e një biznesi të ri nga Shoqëria ;
 - Përcakton shitjen e konsiderueshme të aseteve ose shitjen e kuotave ;

- Emëron dhe shkarkon Administratorët dhe Drejtorin e Financës (‘CFO’);
- Emëron dhe shkarkon ekspertin (-ët) e jashtëm të autorizuar dhe/ose likuiduesin (-it);
- Përcakton shpërblimin e administratorit (-ve), të ekspertit (-ve) të jashtëm të autorizuar, Drejtorit të Financës (‘CFO’) dhe të likuiduesit (-ve);
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së aktivitetit tregtar të përgatitura nga Administratori;
- Vendos për ndryshimet e këtij Akt Themelimi dhe Statuti;
- Vendos mbi zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- Vendos mbi shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
- Vendos mbi destinacionin e humbjeve;
- Vendos mbi ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Vendos mbi hapjen e degëve/zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Miraton cdo financim;
- Miraton barrë siguroese mbi kuotat e Shoqërisë ose vendosjen e pengut7hipotekës mbi cdo pasuri të Shoqërisë;
- Miraton buxhetin vjetor të Shoqërisë;
- Miraton cdo investim që tejkalon buxhetin vjetor;
- Vendos mbi blerjen apo hipotekën e cilësdo pasurie të paluajtshme të shoqërisë;
- Vendos mbi çështje të tjera të parashikuara në ligj.

Kalimi kuotave

Tjetërsimi i kuotave nga ana e Ortakëve kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së Ortakëve të tjerë të Shoqërisë.

Tjetërsimi i kuotave nga ana e Ortakëve kushtëzohet nga detyrimi i Ortakut për të marrë më parë miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për këtë tjetërsim kuotash.

Largimi i Ortakut

Nëse ndonjëri nga ortakët sillet në mënyrë të tillë që pengon aktivitetin normal të shoqërisë; nuk mbron interesat e e saj; vepron në keqbesim; i sjell dëme shoqërisë, atëherë ortakët e tjerë kanë të drejtë të kërkojnë largimin e tij. Në raste të tilla nuk nevojë për miratimin paraprak të ortakut i cili do të largohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 7

Regjistrimi i vendimeve

- 7.1. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve. Regjistri i Vendimeve do të mbahet nga shoqëria dhe cdo regjistrim do të nënshkruhet nga Administratori.

Neni 8

Administratori

- 8.1. Ortaku i vetëm dhe themeluesi i shoqërisë vendosi që Administrator i shoqërisë për 5 (pesë) vite do të jetë **Z. FESTIM BREGASI**
- 8.2. Shoqëria administrohet nga Administratori i saj, i emëruar nga Asambleja e Ortakëve, i cili do të menaxhojë/administrojë aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë.
- 8.3. Afati i emërimit të Administratorit është për një periudhë 5 (pesë) vjecare, i rinovueshëm dhe mund të zgjatet deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së ortakëve, e cila vendos mbi rinovimin e mandatit të tij ose emërimin e Administratorit të ri.
- 8.4. Kompetencat e Administratorit :
- Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e ortakëve;
 - Përfaqëson Shoqërinë ndaj palëve të treta
 - Merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrë të duhur të librave financiarë dhe të dokumentave;
 - Përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore dhe bilancet e konsoliduar, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe ja dorëzon ato Asamblesë së Ortakëve për miratim sëbashku me propozimet mbi shpërndarjen e fitimeve;

- Merr masa për krijimin e sistemeve paralajmëruese në lidhje me rrethana që kërcënojnë aktivitetin tregtar të shoqërisë ;
 - Dorëzon / depoziton pranë QKB të dhëna të dokumentuara të Shoqëris, përvec rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe ;
 - I raporton Asamblesë së Ortakëve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe përmbushjen e veprimeve / transaksioneve me një impakt të rëndësishëm mbi ecurinë e aktivitetit tregtar të Shoqërisë ;
 - Kryen cdo detyrë tjetër të përcaktuar në ligj, në këtë akt apo nga Asambleja e Ortakëve.
- 8.5. Administratori mund të autorizojë përmes një prokure të posacme / autorizimi, cdo palë të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë dhe për të nënshkruar cdo dokument, kërkesë apo aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 8.6. Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për cdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga ligji dhe ky Akth Themelimi dhe Statut.

Neni 9

Eksperti kontabël i jashtëm

- 8.1. Pasqyrat financiare të Shoqërisë mund të auditohen nga një ekspert kontabël i jashtëm, nëse ky auditim vendoset nga Ortakët e Shoqërisë.

**KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

Neni 10

Viti financiar

- 10.1. Viti financiar fillon në i janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit financiar, Administratori harton pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 10.2. Si përjashtim viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në QKB dhe përfundon më 31 Dhjetor 2018.

Neni 11

Shpërndarja e fitimeve

- 11.1. Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, asambleja e Ortakëve do të vendosë në lidhje me shpërndarjen e fitimeve, nëse ka.

**KAPITULLI V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI SHOQËRISË**

Neni 12

Prishja dhe likuidimi

- 11.1. Në rast se Asambleja e ortakëve vendos për prishjen e Shoqërisë, ajo duhet të emërojë një apo më shumë likuidues.

**KAPITULLI VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 13

Ligji i zbatueshëm

- 13.1. Për të gjitha ceshtjet që nuk parashikohen në këtë Akt Themelimi dhe Statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 14

Dispozita të fundit

Ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, me të njëjtën vlerë secila. Në rast mospërputhje mes versionit shqip dhe atij anglisht, përparësi do të ketë versionianglisht.

**Ortaku i Vetëm
Z. FESTIM BREGASI**